



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në
“Bashkinë Këlcyrë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR **AUDITIMIN TEMETIK**

“BASHKIA KËLCYRË”

**(Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020)**

Tiranë, 2021

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 7
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditimit	7 - 9
II	HYRJA	9 - 13
	<ul style="list-style-type: none"> a. <i>Titulli.</i> b. <i>Marrësi.</i> c. <i>Objektivat dhe qëllimi.</i> d. <i>Identifikimi i çështjes.</i> e. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.</i> f. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.</i> g. <i>Kriteret e vlerësimit.</i> h. <i>Standardet e auditimit.</i> i. <i>Metodat e auditimi.</i> j. <i>Dokumenti i auditimit.</i> 	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13 - 22
III.1.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	13 - 22
	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	22 - 25
VI.	ANEKSET	25 - 36

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Këlcyre.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj, 600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një “*Opinion i kundërt*”, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
1.	Në Bashkinë Këlcyre, në vitet 2019 dhe 2020 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 214 Instalime teknike, makineri e pajisje, 215 “Mjete transporti “dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes	E lartë	13-22	Nga Bashkia Këlcyre, të merren masa nga Nëpunësin Zbatues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	<p>në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p>			<p>shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore 214 Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe “215 “Mjete transporti”.</p>
2.	<p>Aktivet Afatgjata Financiare me llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, paraqitet në vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të viteve 2019 dhe 2020 edhe pse Bashkia Këlcyrë zotëron 100% aksione në pjesëmarrje në “U...” sh.a me vlerë 21.259.000 lekë, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.</p>	E lartë	13-22	<p>Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “U...” sh.a me vlerë kontabël 21.259.000 lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.</p>
4.	<p>Gjatë viteve 2019 dhe 2020 balanca e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton në vlerën 6,078,720 lekë me analitik debitorë për penalitete dhe kamatëvonesa. Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2019 dhe 2020 debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar detyrimet për vitin 2020, të cilat janë dërguar me shkresa ,zyrës së financës dhe sipas tyre, detyrimi paraqitet në vlerat 60,386,981 lekë për</p>	E lartë	13-22	<p>Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke të arkëtueshme e taksave dhe tarifave vendore për vlerën 67,572,457 lekë për vitin 2020. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	<p>vitin 2019 dhe 67,572,457 lekë për vitin 2020. Pra është nënvlerësuar borxhi tatimor dhe njëkohësisht Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe Llogaria e 70 “ Të ardhurat nga taksat dhe tatime” duke mos e njohur të ardhurën për vitin 2019 në vlerën 60,386,981 lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 67,572,457 lekë.</p> <p>Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>			
5	<p>Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Te drejta)” ka si balanca përfundimtare vlerat 7,622,212 lekë për vitin 2019 dhe 7,682,672 lekë për vitin 2020. Në mënyrë analitike kjo llogari ka përfshirë në debi, gjendjet e llogarive kreditore të detyrimeve 42 ” Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” dhe 435 “Sigurime Shoqërore” për secilin vit përkatës. Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i tyre këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019. Nisur nga Tabela 1, e paraqitur në anekset e këtij Project raportit, në mënyrë grafike janë paraqitur kontratat e lidhura, vlerat me TVSH, detyrimi i prapambetur (468) dhe të drejtat nga operacionet me shtetin (4342). Për sa i përket të drejtave që i lind subjektit Bashkia Këlcyrë për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit në lidhje me këto angazhime të ndërmarra gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet duke u bazuar në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësave</p>	E lartë	13-22	<p>Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundërparti 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për vlerat 93,921,817 lekë për vitin 2020 dhe me 237,523,073 lekë për vitin 2019. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	<p>të Qeverisjes së Përgjithshme, pika 32 e tij. Ky kontabilizimi nuk është bërë, gjë që ka sjell nënvlerësimin e llogarisë 4342 Operacione me shtetin dhe kundërparti 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” me 93,921,817 lekë për vitin 2020 dhe me 237,523,073 lekë për vitin 2019.</p> <p>Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32.</p>			
6	<p>Në Bilancin Kontabël për vitin 2019 dhe 2020 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2019 paraqitet në vlerën 630,628 dhe për 2020 në vlerën 370,628 lekë. Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2019 dhe 2020, nuk është pasqyruar. Kjo ka bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur 2019 dhe 46,435,474 lekë për vitin financiar të mbyllur 2020, vlera këto të evidentuara dhe pasqyruara në tabelën e investimeve Duhet thënë se këto llogari, janë nënvlerësuar për vitin 2020, për shkak të mos njohjes së detyrimit që lind nga fatura të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2020, përkatësisht në vlerën 32,300,000 lekë Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</p>	E lartë	13-22	<p>Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur 2019, dhe me 46,435,474 për vitin financiar të mbyllur 2020, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej 32,300,000 lekë e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin vitit 2020, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	<p>neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5,6,7,9 dhe 10 urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve., ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” , udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.</p>			
7	<p>Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2020 është në vlerën 124,034,197 lekë, paraqet gjendjen e faturave për investimet kapitale (231) të pa likuiduara nga Bashkia Këlcyrë (<u>duke përfshirë dhe investimet me buxhet shteti</u>) më 31.12.2020. Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 124,034,197 lekë përbëhet nga fatura të palikujduara (<u>duke përfshirë dhe investimet me buxhet shteti</u>), për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës në shumën si paga, sigurime, etj. Vihet re se kreditimi i kësaj llogarie ka ardhur nga debitimi i llogarisë ose kundërparti 411 “Klientë e llogari të ngjashme” në vlerën 124,034,197 lekë</p> <p>Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ,ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë</p>	E lartë	13-22	Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 411“Klientë e llogari të ngjashme” dhe llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në vlerën 124,034,197 lekë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	e qeverisjes së përgjithshme” pika 2.1 e tij.			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Këlcyrë për vitin ushtrimor 2020 , të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve , pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i kundërt²:

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Këlcyrë duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020”.

Baza për opinion të kundërt:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700), *ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450 shprehet : “Objektivi i audituesit është të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit”*

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiarë të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është **467,462 lekë** Çdo gabim apo shumë e gabimeve mbi këtë vlerë, e cila përbën gabim material, dhe të përhapur në llogaritë vjetore të vitit 2020 , në bazë të **ISSAI 1705** përbën bazë për opinion të kualifikuar. Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2020 paraqitet në si më poshtë:

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 21.259.000 lekë në vitin 2020

² **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar me 67,572,457 lekë për vitin 2020
Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” është nënvlerësuar me 93,921,817 lekë për vitin 2020
Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” është nënvlerësuar me 93,921,817 lekë për vitin 2020

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është nënvlerësuar me 46,435,474 lekë për vitin 2020

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është nënvlerësuar me 46,435,474 lekë për vitin 2020

Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme” është mbivlerësuar me 124,034,197 lekë për vitin 2020

Gabimet materiale janë individualisht dhe si shumë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2020 (materialiteti **467,462 lekë**), dhe janë gabime materiale të shpërhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të kundërt të Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit .

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Këlcyrë.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Këlcyrë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

II/1. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.6.2021 dhe autorizimit nr. 678/4, datë 14.6.2021 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.6.2021 – 2.7.2021, në subjektin Bashkia Këlcyrë për periudhën

e veprimtarisë nga 01.01.2020 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar mbi pasqyrat financiare viti 2020”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ**, *Përgjegjës Grupi*
2. **E. C**, *Auditues*

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Këlcyrë.

b- Marrësi: Projekt Raporti i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkinë Këlcyrë.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përpunshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Këlcyrë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Këlcyrë.

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) **K. N** me funksion Kryetar i Bashkisë Këlcyrë dhe Drejtore e Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ) **V. K**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar

të Bashkisë Këlcyrë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34, pika 6³, neni 65, pika 1⁴ dhe neni 91, pika 1.3⁵.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Këlcyrë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arrijtjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës.

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.

- *Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

³ “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”

⁴ “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

⁵ “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
- ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”.

- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria*: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi*: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodatat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*⁶.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te

⁶ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- **Kontrolli i vlerësimit.** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- **Konfirmim nga të tretët.** Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- **Kontrolli sipas një treguesi.** Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në

kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁷. Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese. Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të kundërshtive të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit ky Raport Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".

Në subjektin e auditimit Bashkia Këlcyrë, mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël" pjesa e parë "Rregulla të përgjithshme" kapitulli i parë "Mbajtja e kontabilitetit" dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme". Duhet theksuar se vazhdon mbajtja e kontabilitetit pa një program kontabël, por çdo gjë regjistrohet në Excel, që përbën dhe risk në ruajtjen e të dhënave. Pasqyrat financiare janë paraqitur në formatin e tyre të plotë, siç e parashikojnë dhe anekset e udhëzimit I MF. nr.08, datë 09.03.2018. nën gjykimin tonë është përcaktuar pragu I materialitetit, sipër të cilit janë testuar llogaritë kontabël si dhe është përcaktuar materialiteti sasior, bazuar në manualin e auditimit financiarë, me metodën e përqindjes mbi shpenzimet korrente dhe kapitale, dhe përkatësisht marrin vlerat **497,038 lekë** për vitin 2019 dhe **467,462 lekë** për vitin 2020.

⁷ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

1. Titulli i gjetjes: *Mungesa e një regjistri kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale si dhe mangësira në inventarizimin e tyre*

Situatë:

Në Bashkinë Këlcyrë, në vitet 2019 dhe 2020 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 214 Instalime teknike, makineri e pajisje, 215 “Mjete transporti “dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102, 103 e tij

Ndikimi/Efekti:

Vlerat përkatëse në pasqyrat financiare jo të bazuara në inventarizim të përvitshëm si dhe mungesë informacioni në mënyrë analitike për secilin aset si pasojë e mungesës së një regjistri kontabël.

Shkaku:

Mosnjohje e moszbatim i udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Këlcyrë, të merren masa nga Nëpunësin Zbatues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore 214 Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe “215 “Mjete transporti”.

Konkluzion: Mungesa e regjistrit të aktiveve dhe mos respektimi i udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” për sa i përket inventarizimit të aktiveve çdo vit, ka sjellë pasiguri në paraqitjen e vlerës së tyre reale në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2019 dhe 2020. Ngritja e urdhrave për inventarizim si dhe krijimi i regjistrit të aktiveve, përbën hapin kryesor në menaxhimin e tyre nga Nëpunësi Autorizues. Nuk janë ndërmarrë procedurat e inventarizimit çdo vit, në kundërshtim me udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe janë përjashtuar nga inventarizimi pjesa më e madhe e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, si dhe nuk është hartuar regjistri i aktiveve përkatëse. Në mënyrë të

menjëhershme duhet të merren masa nga nëpunësi autorizues dhe zbatues për nxjerrjen e urdhrave të inventarizimit, ngritjen e grupit të punës për hartimin e regjistrave kontabël

2. Titulli i gjetjes: *Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitet 2019 dhe 2020.*

Situatë:

Bashkia Këlcyrë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 02/11/2016 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të U.... Sh.a. me NUIS “K...” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 21.259.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 21.259.000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë në “U.... “ Sh.a. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 21.259.000 lekë dhe investori është Bashkia Këlcyrë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **21.259.000 lekë** përbën deformim të informacionit financiar.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 dhe 2020 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, gjendja kjo e nën vlerësuar me **21.259.000 lekë**

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”, Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” dhe Standartit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “U....” sh.a me vlerë kontabël **21.259.000 lekë** në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

Konkluzion: Bashkia Këlcyrë, në mënyrë që të pasqyrojë pjesëmarrjen 100% të saj në aksionet e UK Këlcyrë sh.a, duhet, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes me vlerë kontabël **21.259.000 lekë** në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet

3. Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogaria e 70 “ Të ardhurat nga taksat dhe tatime” për vitet 2019 dhe 2020.

Situatë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2020 është 6,078,720 lekë e cila përbëhet nga shuma prej 1,688,991 lekë, të debitorëve e zënë debitorët e krijuar nga rekomandimet e lëna nga KLSH (njësia vendore Dishnicë) dhe debitorët e tatim taksave e te tjerë te ndryshëm te krijuara nder vite ne shumen 4,389,729 leke.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	6,078,720
Shtesa gjatë vitit 2020 debitorët e taksave (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
Gjendja në 31.12.2020	6,078,720

Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2019 dhe 2020 debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar detyrimet për vitet 2019 dhe 2020, detyrimi paraqitet si më poshtë vijon;

Debitore Bashkia Kelcyre dhe NJA	Gjendja 31.12.2019	Gjendja 31.12.2020
Debitore Biznes i Madh	7,759,944	3,567,233
Debitore Biznes i Vogel	15,093,078	15,998,194
Debitore nga Taksa e tokes bujqesore	33,207,564	37,372,564
Debitore nga Taksat e familjes	4,326,395	5,401,127
Totali	60,386,981	67,572,457

Pra është nënvlerësuar Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe Llogaria e 70 “ Të ardhurat nga taksat dhe tatime”, duke mos e njohur të ardhurën për vitin 2019 në vlerën 60,386,981 lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 67,572,457 lekë.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018

“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të taksave dhe tarifave të arkëtueshme paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Këlcyre, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke të arkëtueshme e taksave dhe tarifave vendore për vlerën 60,386,981 lekë për vitin 2019 dhe 67,572,457 lekë për vitin 2020. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

Konkluzion: Të arkëtueshme që vijnë nga detyrimi që kanë subjektet biznesi i madh, i vogël, taksat familjare e të tokës bujqësore si dhe detyrimet që i lindin çdo subjekti fizik ose juridik dhe që i nënshtrohet ligjit për taksat dhe tarifatat vendore, kanë qenë të paregjistruara për periudhën për të cilën jepet opinion mbi pasqyrat financiare. Nga ana e Bashkisë Këlcyre të merren masa të menjëhershme për regjistrimin e këtyre debitorëve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar si dhe të bëhet rregullimi në Pasqyrën e Performancës Financiare në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim për të ardhurat e panjohura të vitit përkatës 2019 dhe 2020, për shkak të mos regjistrimit si të arkëtueshme.

4. Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e kontratave të investimit dhe njohjes së të drejtës për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit për këto investime publike për vitet 2019 dhe 2020

Situata:

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 7,682,672 lekë dhe kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 7,682,672 lekë. Vlera prej 7,682,672 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	7,622,212
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	60,460
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
Gjendja në 31.12.2020	7,682,672

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-409	

Paga personeli llog 42	5,291,262
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	162,314
Sigurime shoqërore e shëndetësore llog.435-436	1,858,468
Shpenzime gjyqësore	370,628
Totali	7,682,672

Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i tyre këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019. Nisur nga Tabela 1, e paraqitur në anekset e këtij Project raportit, në mënyrë grafike janë paraqitur kontratat e lidhura, vlerat me TVSH, detyrimi i prapambetur (468) dhe të drejtat nga operacionet me shtetin (4342). Për sa i përket të drejtave që i lind subjektit Bashkia Këlcyrë për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit në lidhje me këto angazhime të ndërmarra gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet duke u bazuar në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, pika 32 e tij. Ky kontabilizimi nuk është bërë, gjë që ka sjell nënvlerësimin e llogarisë 4342 Operacione me shtetin dhe kundërpartit 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.me 93,921,817 lekë për vitin 2020 dhe me 237,523,073 lekë për vitin 2019

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 .

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyrë ndaj shtetit për angazhimet e ndërmarra me fondet nga buxheti i shtetit, të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 dhe 2020 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Njësimit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundërpartit 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për vlerat 93,921,817 lekë për vitin 2020 dhe me 237,523,073 lekë për vitin 2019 . Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020..

Konkluzion: Të drejtat që lindin për financime të pritshme për angazhimet buxhetore të ndërmarra nga subjekti Bashkia Këlcyrë dhe me burim financimi buxhetin e shtetit, nuk janë paraqitur dhe reflektuar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe Pasqyrën e Performancës Financiare për vitet 2019 dhe 2020. Nga ana e subjektit duhen marrë masa me mbylljen e vitit fiskal 2021 për sistemimet e financimeve të pritshme nga angazhimet e ndërmarra.

5. Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e shpenzimeve të periudhave të ardhshme për kontratat e investimeve publike për vitet 2019 dhe 2020.

Situatë:

Sipas konstatimit dhe analizës që i është bërë këtyre kontratave të tabelës 1, kemi përpunuar të dhënat e subjektit ku sinjalizohet gjendja e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale, si për vitin 2019 ashtu edhe për vitin 2020. Ky përpunim të dhënash është realizuar me qëllim testimin e saktësisë së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” si llogari debitorë dhe testimin e saktësisë së llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. si llogari kreditore të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinacuar, për shkak të mungesës së fondeve (në rastin tonë, i kemi shpenzime kapitale). Duke e bazuar procedurën e testimit substancial në pikën 42 të udhëzimit nr.8 datë 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme“, po paraqesim më poshtë tabelën e kontratave së bashku me gjendjen e detyrimit të prapambetur, i cili duhej të ishte regjistruar në bilancin kontabël 2019 dhe 2020

Viti	Kontrata	Financimi ne PBA					Detyrimi prapambetur 486			
		2017	2018	2019	2020	2021	2017	2018	2019	2020
2017	Rijetazimi i Pedonale dhe hapësirave rekreative ne shtetin qendror. (5%G.PUNIMI)	37,227,210	111,555,902				-	4,333,838	4,333,838	-
	Shtimi i pjeseve te veshtira te rugave rurale dhe permissimi i kembereve te	14,936,891					12,285,891	7,794	7,794	7,794
2018	Rikonstruksion i Ures ne qendert te zyrtet Kalcyre dhe		4,943,420					1,702,870	-	-
	Rikonstruksion i rrethit te brendshem te ujesjellesit Kalcyre, Bashkia Kalcyre, Faza I		33,038,531	63,952,395				7,567	(7,567)	-
	Projekte per permissimin e kushteve te banimit per komunitete te palokozuara,		6,675,378	5,995,727				1	(1)	-
	Rehabilitim i skemes ujtase te rezervuareve Kalcyre dhe Vantop (5%G.PUNIMI)		19,143,021					-	-	-
2019	Rikonstruksion Shkolla e Mesme Kalcyre dhe 5% garanci punimi			30,825,000	25,779,874				713	5,670,861
	Rikonstruksion i rugave te lagjes se Sptalit dhe 5% garanci punimi			5,000,000	29,858,247				-	24,858,247
	Sistemim asfaltim rruge, Suke-Podgoran Fusha, rruge Gorice, rruge Komarak e Vinoka			15,455,000	20,898,317				371	15,898,317
	Sistemi ujtase Ballaban, Ujiqja e fushes Ballaban, vazhdim			10,000,000	17,384,647				381	435
	Ndërtimi i rrethit te jashtem te ujesjellesit Kalcyre			35,625,220	53,437,829	88,403,558			285	
	Supërizim punimesh per Ndërtimi i rrethit te jashtem te ujesjellesit Kalcyre			521,248	781,871	977,862			-	
2020	Projekte per permissimin e kushteve te banimit per komunitete te palokozuara , B. Kalcyre				12,768,908	5,428,038				-
	Total	52,213,101	175,368,252	167,174,590	148,140,785	89,381,290	12,285,891	6,052,070	4,335,775	46,435,474

Burimi: Te dhënat e subjektit përpunuar nga audituesi Ehas Caustrej

Në Bilancin Kontabël për vitin 2019 dhe 2020 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2019 në vlerën 630,628 dhe për vitin 2020 në vlerën 370,628 lekë. Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2019 dhe 2020, nuk është pasqyruar. Kjo ka bërë të mundur nën vlerësimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur në 2019 dhe me 46,435,474 lekë për vitin financiar të mbyllur në 2020..

Duhet thënë se këto llogari, janë nënvlerësuar për vitin 2020, për shkak të mos njohjes së detyrimit që lind nga fatura të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2020, përkatësisht në vlerën **32,300,000 lekë**

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5,6,7,9 dhe 10 urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve., ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të shpenzimeve të periudhave të ardhshme në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 dhe 2020 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare si dhe mos regjistrimi i faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2020

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” dhe kundërpartit të saj 467 “ *Kreditorë të ndryshëm*” me 4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur 2019 dhe 46,435,474 lekë për vitin financiar të mbyllur 2020, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej 32,300,000 lekë e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin vitit 2020, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërpartit të saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Konkluzion: Niveli shpenzimeve të periudhave të ardhshme duhet plotësuar dhe raportuar dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për diferencat të cilat nuk janë paraqitur si detyrim i prapambetur. Nga ana tjetër duhen bërë veprimet sistemuese për kontabilizimin e vlerave të sipërcituara në llogaritë përkatëse kontabël me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

6. Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” në vlerën 124,034,197 lekë

Situatë:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2020 është në vlerën 124,034,197 lekë, paraqet gjendjen e faturave për investimet kapitale (231) të pa likuiduara nga Bashkia Këlcyrë (*duke përfshirë dhe investimet me buxhet shteti*) më 31.12.2020. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"	
Çelje e vitit 2020	938,636
Shtesa (K)	124,034,197
Pakësime (D)	938,636
Gjendja në 31.12.2020 (K)	124,034,197

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 124,034,197 lekë përbëhet nga fatura të palikujduara (*duke përfshirë dhe investimet me buxhet shteti*), për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës në shumën si paga, sigurime, etj. Vihet re se kreditimi i kësaj llogarie ka ardhur nga debitimi i llogarisë ose kundërparti 411 "Klientë e llogari të ngjashme" në vlerën 124,034,197 lekë

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 2.1 e tij ku citohet:

"Në rastet e daljeve të aktiveve afatgjata, funksionimi kontabël është si më poshtë:

a) Për shitjen e aktiveve afatgjata, funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit është (vlera neto):

Kreditohen llogaritë 20, 21, 24 (analizat shtatëshifrore përkatëse);

Debitohet 1014 "Pakësim fondesh nga shitja e AAGJ".

b) Për shitjen e aktiveve afatgjata, me çmimin e shitjes:

Debitohet 411 "Klientë" ose 520 "Disponibilitete në thesar" (analizat shtatëshifrore përkatëse);

Kreditohet 116 "Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme".

c) Për daljet e aktiveve afatgjata nga nxjerrjet jashtë përdorimit, funksionimi kontabël i koston historike dhe amortizimit (vlerës neto) është:

Kreditohen llogaritë 20, 21, 24 (analizat shtatëshifrore përkatëse);

Debitohet 1015 "Pakësim fondesh nga nxjerrjet jashtë përdorimit të AAGJ".

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të të ardhurave të krijuara nga shitja e aktiveve për vitin 2020.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Këlcyre, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 411 "Klientë e llogari të ngjashme" dhe llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në vlerën 124,034,197 lekë. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Këlcyrë, në vitet 2019 dhe 2020 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 214 Instalime teknike, makineri e pajisje, 215 “Mjete transporti “dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. *(Trajtuar në pikën 3, faqe 9-18, të Projekt Raportit të Auditimit.)*

Rekomandimi 1.1: Nga Bashkia Këlcyrë, të merren masa nga Nëpunësin Zbatues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore 214 Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe “215 “Mjete transporti”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Aktivet Afatgjata Financiare me llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, paraqitet në vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të viteve 2019 dhe 2020 edhe pse Bashkia Këlcyrë zotëron 100% aksione në pjesëmarrje në “U...” sh.a me vlerë 21.259.000 lekë, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje” *(Trajtuar në pikën 3, faqe 9-18, të Projekt Raportit të Auditimit.)*

Rekomandimi 2.1: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “U...” sh.a me vlerë kontabël **21.259.000 lekë** në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë viteve 2019 dhe 2020 balanca e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton në vlerën 6,078,720 lekë me analitik debitorë për penalitete dhe kamatëvonesa. Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2019 dhe 2020 debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar detyrimet për vitin 2020, të cilat janë dërguar me shkresa ,zyrës së financës dhe sipas tyre, detyrimi paraqitet në vlerat **60,386,981 lekë për vitin 2019 dhe 67,572,457 lekë për vitin 2020**. Pra është nënvlerësuar borxhi tatimor dhe njëkohësisht Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe Llogaria e 70 “ Të ardhurat nga taksat dhe tatime”

duke mos e njohur të ardhurën për vitin 2019 në vlerën 60,386,981 lekë **dhe për vitin 2020** në vlerën **67,572,457 lekë**.

Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Trajtuar në pikën 3, faqe 9-18, të Projekt Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 3.1: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke të arkëtueshme e taksave dhe tarifave vendore për vlerën **67,572,457** lekë për vitin 2020. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifavat vendore për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Te drejta)” ka si balanca përfundimtare vlerat 7,622,212 lekë për vitin 2019 dhe 7,682,672 lekë për vitin 2020. Në mënyrë analitike kjo llogari ka përfshirë në debi, gjendjet e llogarive kreditore të detyrimeve 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” dhe 435 “Sigurime Shoqërore” për secilin vit përkatës. Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i tyre këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019. Nisur nga Tabela 1, e paraqitur në anekset e këtij Project raportit, në mënyrë grafike janë paraqitur kontratat e lidhura, vlerat me TVSH, detyrimi i prapambetur (468) dhe të drejtat nga operacionet me shtetin (4342). Për sa i përket të drejtave që i lind subjektit Bashkia Këlcyrë për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit në lidhje me këto angazhime të ndërmarra gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet duke u bazuar në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, pika 32 e tij. Ky kontabilizimi nuk është bërë, gjë që ka sjell nënvlerësimin e llogarisë 4342 Operacione me shtetin dhe kundërparti 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” me 93,921,817 lekë për vitin 2020 dhe me 237,523,073 lekë për vitin 2019.

Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32. (Trajtuar në pikën 3, faqe 9-18, të Projekt Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 4.1: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundërparti 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për vlerat 93,921,817 lekë për vitin 2020 dhe me 237,523,073 lekë për vitin 2019. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Në Bilancin Kontabël për vitin 2019 dhe 2020 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2019 paraqitet në vlerën 630,628 dhe për 2020 në vlerën 370,628 lekë. Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2019 dhe 2020, nuk është pasqyruar. Kjo ka bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” me **4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur 2019 dhe 46,435,474 lekë për vitin financiar**

të mbyllur 2020, vlera këto të evidentuara dhe pasqyruara në tabelën e investimeve Duhet thënë se këto llogari, janë nënvlerësuar për vitin 2020, për shkak të mos njohjes së detyrimit që lind nga fatura të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2020, përkatësisht në vlerën **32,300,000 lekë**

Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5,6,7,9 dhe 10 urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve., ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” , udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42. (Trajtuar në pikën 3, faqe 9-18, të Projekt Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 5.1: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “ Kreditorë të ndryshëm” me 4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur 2019, dhe me 46,435,474 për vitin financiar të mbyllur 2020, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej **32,300,000** lekë e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin vitit 2020, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “ Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2020 është në vlerën 124,034,197 lekë, paraqet gjendjen e faturave për investimet kapitale (231) të pa likuiduara nga Bashkia Këlcyrë (duke përfshirë dhe investimet me buxhet shteti) më 31.12.2020. Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 124,034,197 lekë përbëhet nga fatura të palikujduara (duke përfshirë dhe investimet me buxhet shteti), për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës në shumën si paga, sigurime, etj. Vihet re se kreditimi i kësaj llogarie ka ardhur nga debitimi i llogarisë ose kundërparti 411 “Klientë e llogari të ngjashme” në vlerën 124,034,197 lekë

Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ,ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 2.1 e tij (Trajtuar në pikën 3, faqe 9-18, të Projekt Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 9.1: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” dhe llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në vlerën 124,034,197 lekë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT